



## REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

---

Kom.Dh.Shk.II.nr.954/2022

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS- Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Krenar Berisha kryetar, Saranda Bogaj Sheremeti dhe Dren Rogova, anëtar, në konfliktin administrativ, sipas padisë së paditëses Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike (KEC/CO) sh.a nga Prishtina, të cilën me autorizim e përfaqëson E.M. zyrtar i paditëses, kundër të paditurit Zyra e Rregullatorit për Energji në Prishtinë, e përfaqësuar nga Sh.M., me bazë juridike: anulim i vendimit, duke vendosur sipas ankesës së palës paditëse, të ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative A.nr.575/2019 të datës 10.11.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 10.05.2023, merr këtë:

### A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e paditëses Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike (KEC/CO) sh.a nga Prishtina, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative A.nr.575/2019 i datës 10.11.2021, VËRTETOHET.

### A r s y e t i m

Me Aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës së shkallës së parë, është refuzuar si e bazuar Kërkesëpadia e paditëses Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike (KEC/CO) sh.a nga Prishtina, me të cilën ka kërkuar që të anulohet vendimi i paditurit Zyra e Rregullatorit për Energji në Prishtinë, nr. V\_1104\_2019 i dt.28.01.2019, si e pabazuar.

Kundër këtij Aktgjykimi, pala paditëse, ka ushtruar ankesë me të cilën e konteston ligjshmërinë e tij, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të LPK-së, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet ankesa si e bazuar, anulohet aktgjykimi A.nr.575/19 dt.10.11.2021 i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, si i pabazuar, miratohet kërkesëpadia e paditëses ashtu që të anulohet vendimi i të paditëses V\_1104\_2019 dt.28.01.2019 si i pabazuar. Aktgjykimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë është i mangët dhe kontradiktor me vetveten, dhe se vendimin e paditëses e kemi kontestuar për shkak se janë cënuar rendë dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative nr.05/L-031, neni 48. Gjykata e shkallës së parë i ka pranuar apriori vendimet e ZRRE, duke mos i marrë për bazë argumentet dhe provat e palës paditëse.

Dhomat e shkallës së dytë e Gjykatës Komerciale të Kosovës, shqyrtoi shkresat e lëndës aktgjykimin e ankimuar pretendimet në ankesë, dhe pas vlerësimit të tyre si në vështrim të nenit 12 të Ligjit 08/L-015, dhe nenit 49 të LKA-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se në procedurën administrative të ankesave, e paditura Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji me vendimin kontestues nr. V\_1104\_2019 i dt.28.01.2019, ka refuzuar ankesën e KESCO-së, ndaj vendimit të DMK-së, për konsumtaorin S.H. nga Prishtina, me shifer konsumatorit DPR-... si të pabazuar, dhe ka lënë në fuqi vendimin e Departamentit per Mbrojtjen e konsumatorve nr.ZRRE/DMK\_V\_1889\_11\_18 dt.20.11.2018.

Paditësja ndaj këtij vendimi përfundimtar në procedurën administrative, me padin e datës 06.03.2019 ka inicuar në gjykatë, konflikt administrativ kunder të paditues, me të cilën ka kërkuar aprovimin e padis dhe anulimin e vendimit të paditues. Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për qështje administrative, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor në prani të përfaqësuesve të autorizuar të palëve ndërgjyqëse, dhe administrimit të provave, me Aktgjykimin A.nr.575/19 dt.10.11.2021 ka refuzuar kërkespadin e paditëses, me të cilën ka kërkuar që të anulohet vendimi i të paditurit Zyra e Rregullatorit per Energji në Prishtinë, nr. V\_1104\_2019 i dt.28.01.2019.

Gjykata e shkallës së parë në arsyetim të aktgjykimit është referuar në dispozitat e nenit 15 paragrafi 1 të Ligjit per Rregullatorin e Energjisë, dhe nenit 5 të Rregulles për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji. Gjykata vëren se paditësi ka pasur evidentime dhe reagime të mëvonshme, referuaar gjendjes faktike që ka konstatuar si në procesverbale dhe ndërimi i grupit tarifor evidentohet shumë më i vonshëm se periudha e identifikimeve të gjendjes. Korigjimi per periudhën 11/2015-10/2016 nuk bazohet në korigjimet referuar periudhës së konstatimit të grupit tarifor si ne procesverbalet e dates 22.09.2016 dhe 17.03.2016, korigjimi nuk është në përputhshmëri me detyrimin e respektimit të rregullit se furnizuesi është i detyruar të siguroj që konsumatorët të jenë të faturuar për energjinë e shpenzuar dhe per tarifa tjera, sipas struktures tarifore të përcaktuar dhe në përputhje me llojin e tarifës së dakorduar me konsumatorin.

Dhomat e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale të Kosovës, këtë qëndrim juridik të gjykatës së shkallës së parë, e vlerëson si të rregullt dhe të bazuar në ligj, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me zbatim të gabuar të dispozitave ligjore.

Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar në kuptim të nenit 44 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), në drejtim të thënieve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës, aktgjykimin e ka mbështetur në dispozitat e Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, dhe Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji. Gjykata e shkallës së parë në arsyetim të aktgjykimit të ankimuar ka dhënë konstatimet faktike lidhur me parregullsitë procedurale dhe ligjore të paditëses e cila nuk ka vepruar konform dispozitave ligjore dhe nuk ka dëshmuar përmbushjen e detyrimit për leximin dhe faturimin çdo muaj, prandaj Kolegji, vlerësoi se e paditura dhe gjykata me të drejt kanë ndryshuar gjendjen faktike kur e kanë konsideruar të gabuar faturimin e konsumatorit me shifër DPR ... dhe kanë obliguar

paditësen që të shkarkon konsumatorin nga korigjimi 87789DPR-... datë 23.11.2016 në vlerë prej 508.34€, dhe kanë obliguar paditësen që konsumatorit S.H. nga Prishtina me shifër DPT-... ti korigjon faturat për periudhën 11/2015 deri 10/2016 në vlerë 253.78€.

Pretendimet ankimore të paditëses, se aktgjykimi i atakuar është i mangët dhe kontradiktor me vetveten, dhe se vendimin e paditures e kemi kontestuar për shkak se janë cënuar rendë dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative nr.05/L-031, neni 48, Kolegji i Dhomës së shkallës së dytë, i refuzoi si të pabazuara, ngase aktgjykimi i atakuar i shkallës së parë nuk ka të meta për shkak të së cilave nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, dispozitivi i aktgjykimit është i kuptueshëm, nuk është në kundërtënie me vetveten ose me arsyet e aktgjykimit dhe se aktgjykimi përmban arsye të mjaftuara dhe bindëse për gjendjen faktike dhe juridike, për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilat në tërësi i aprovon edhe Dhoma e Shkallës së Dytë.

Nga një gjendje e tillë faktike nga e cila rezulton se paditësja nuk ka bërë një vlerësim të drejtë të gjendjes faktike, gjatë matjes së shpenzimit të energjisë elektrike për periudhën 11/2015 deri 10/2016, si rezultat i së cilës është aplikuar gabimisht edhe e drejta materiale, Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, i vlerëson si të drejta konstatimet e paditurës dhe gjykatës së shkallës së parë, e cila në procedurë të konfliktit administrativ, në seancën gjyqësore të mbajtur me datë 10.11.2021 në prani të përfaqësuesve të autorizuar të palëve ndërgjyqëse, nga administrimi i provave dhe deklaratimet e palëve prezentë në seancën e shqyrtimit kryesor, vërteton drejt gjendjen faktike, dhe duke u bazuar në dispozitat ligjore, me të drejtë refuzon kërkesëpadinë e paditëses si të pabazuar.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejt ka zbatuar të drejtën materiale respektivisht dispozitat ligjore nenit 15 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë, dhe nenin 5, 23 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, nga ZRRE, që rregullon çështjen e leximit të njehsorëve të energjisë elektrike, sikurse në rastin konkret tek konsumatori S.H. nga Prishtina, me shifër DPR-....

Kolegji, pranon edhe konstatimet e gjykatës së shkallës së parë, se e paditura ka vepruar drejtë kur me vendimin administrativ të kundërshtuar me padinë, ka kërkuar që të korigjohet fatura e periudhës 11/2015 deri 10/2016 dhe ti bëhet konsumatorit zbritja e shpenzimit të kërkuar, bazuar në nenin 5 paragrafi 1.5 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji Elektrike

Andaj Dhomat e Shkallës së Dytë, gjen se aktgjykimi i ankimuar, nuk është i përfshirë me shkelje procedurale dhe ligjore siç pretendohet në ankesë, Gjukata e shkallës së parë, në bazë të provave të administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, në kuptim të nenit 44 të LKA-së dhe në bazë të fakteve të vërtetuara në procedurë administrative, ka nxjerrë prova të mjaftueshme, dhe në mënyrë të drejtë e ka vërtetuar vet gjendjen faktike, dhe ka vendosur meritorisht për çështjen juridike si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Dhomat e Shkallës së Dytë, i refuzoi si të pabazuara pretendimet ankimore, për faktin se gjykata e shkallës së parë ka bërë administrimin e provave dhe fakteve të ofruara nga paditësi dhe e paditura, si dhe ka bërë elaborimin e tyre në përputhje me dispozitat ligjore.

Kolegji i shqyrtoi edhe pretendimet e tjera të palës ankuese në ankesë, mirëpo të njëjtat ishin të pa bazuara dhe nuk kishin ndonjë ndikim në vendosje ndryshe, andaj edhe vendosi që aktgjykimin e shkallë së parë ta vërteton si të drejtë dhe të ligjshëm.

Mbi këtë bazë, e në mbështetje të nenit 12 të Ligjit 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, lidhur me nenin 49 LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**  
Dhomat e Shkallës së Dytë  
Kom.Dh.Shk.II.nr.954/2022 datë 10.05.2023

Kryetari i kolegjit-gjyqtari,  
Krenar Berisha